



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

2197
Nr. 2197 prot.

Memaliaj më 24.12. 2025

Procesverbal

Përshëndetje! Po hapim këtë mbledhje të këshillit të datës 27.11.2025.
Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e fillimit të mbledhjes 13 këshilltarë.
Ora e fillimit të mbledhjes 13:00.
Njohja me rendin e ditës.
Rendin e ditës dhe gjithë dokumentacionin përkatës e keni të gjithë para.
Pika 1 e rendit të ditës. Miratimi i rendit të ditës .

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.10.2025.
3. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për muajin qershor 2025".
4. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin korrik-gusht-shtator 2025".
5. **Projekt vendim:** "Për pranim në shtëpinë e të moshuarve të Z.Dylber Remzi Hasanaj".
6. **Projekt vendim:** "Për pranim në shtëpinë e të moshuarve të Znj.Hazbie Feti Xifa".
7. **Projekt vendim:** "Për pranim në shtëpinë e të moshuarve të Z.Serjan Hasan Rapaj".
8. **Projekt vendim:** "Për emërtim rruge në fshatin Gllavë në Njësinë Administrative Buz".
9. **Projekt vendim:** "Për miratimin e "Shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në qytetin Memaliaj, dhe transportin e mbeturinave Fshat Memaliaj, Lulëzim, Toç, Qesarat, Iliras dhe Vasjar (agjensia luftinjë)".

Esmerald Xhemali: Kam një propozim për ndryshim të rendit të ditës të shtohet në pikën 3 të rendit të ditës një pikë për diskutim. Plani i punës , i aktiviteteve dhe buxhetit për vitin 2026 duke qenë se i parashikuar ka qenë për muajin tetor 2025. Planifikimi i hartimit të planit të punës dhe buxhetit për vitin 2026. Meqë ne u mbledhëm para disa ditësh një grup këshilltarësh po edhe për realizimin e planit dhe buxhetit për vitin që po mbyllet. Propozoj që të futet në rend dite. Nuk e di nëse do ta kem konsensusin e kolegëve apo jo.
Erjon Sinanaj/ Kryetar këshilli: Përsa i përket këtij propozimi që bëri Esmeraldi pasi është dërguar dhe një shkresë nga ana e komisionit të ekonomisë Znj.Edmonda Harizi në muajin e kaluar të cilën e kemi diskutuar në mbledhjen e kaluar përveç kësaj siç thatë dhe ju Esmerald , ju jeni mbledhur dhe keni diskutuar në lidhje me Planin e punës së këshillit për vitin 2026 si dhe

buxhetin. Edhe në procesverbalin e mbajtur ky kishte qenë dhe propozimi juaj për ta shtuar si diskutim në rendin e ditës së kësaj mbledhje.

Flamur Mushamati: Edhe unë jam plotësisht dakord me propozimin e Esmeraldit .

Taulant Rama: Unë jam plotësisht dakord me propozimin e Esmeraldit por do të doja të ishte këtu përfaqësuesi i bashkisë të flitet për çështjen e mbarëvajtjes së buxhetit, ju kam dërguar një email ku ju kam vënë në dijeni se unë nuk jam dakord të kemi një buxhet dhe një plan pasi administrata nuk e zbaton këtë vendim madje në një mbledhje na janë dhënë dhe përgjigje fyese nga drejtori i financës. Mbështetur në këtë argument propozoj të mos ketë një vendim për plan dhe buxhet të këshillit për vitin 2026.

Hidhet në votim propozimi i Esmerald Xemalit të miratohet rendi i ditës me ndryshime.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.10.2025.
3. Diskutim: Planifikimi i hartimit të planit të punës dhe buxhetit për vitin 2026.
4. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për muajin qershor 2025”.
5. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin korrik-gusht-shtator 2025”.
6. **Projekt vendim:** “Për pranim në shtëpinë e të moshuarve të Z.Dylber Remzi Hasanaj” .
7. **Projekt vendim:** “Për pranim në shtëpinë e të moshuarve të Znj.Hazbie Feti Xifa ” .
8. **Projekt vendim:** “Për pranim në shtëpinë e të moshuarve të Z.Serjan Hasan Rapaj ” .
9. **Projekt vendim:** “Për emërtim rruge në fshatin Gllavë në Njësinë Administrative Buz” .
10. **Projekt vendim:** “Për miratimin e “Shërbimit të pastrimit, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në qytetin Memaliaj,dhe transportin e mbeturinave Fshat Memaliaj, Lulëzim, Toç, Qesarat,Illiras dhe Vasjar (agjensia luftinjë)”.

Vota Pro 14

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0. Miratohet.

Pika 2 e rendit të ditës. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27.10.2025.

Nuk ka diskutuame, hidhet në votim.

Vota Pro 13

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 1 F.Mushamati. Nuk kam qenë në mbledhjen e kaluar.

Pika 3 e rendit të ditës. Diskutim mbi hartimin e planit të punës dhe buxhetit për vitin 2026.

Esmerald Xhemali: Në lidhje me planin e vitit 2025 po ti marrim muajt me rradhë është realizuar plani për muajt janar,shkurt,mars,prill. Në muajin maj nuk është realizuar dëgjuesat për pba duke mos ardhur në kohë projekt drafti. Në qershor është miratuar Pba .

Në muajin gusht nuk ka ardhur informacion nga zyra e arsimit kulturës për përgatitjen e ambienteve të shkollave për fillimin e vitit shkollor 2025-2026.Në shtator raporti për realizimin e buxhetit dhe të ardhurave për 8 - muajin nuk është paraqitur nga administrata. Drejtoria e financës dhe e taksave nuk ka sjellë raportin përkatës dhe për muajin tetor e njëjta gjë janë bërë mbledhjet e Këshillit dhe mbledhjet e komisioneve, të pa realizuar dëgjuesat për projekt buxhetin , raportimi nga njësitë administrative për problematikat mbeten të parealizuara. Në këto kushte unë jam dakord me Taulantin për sa kohë ne planin nuk e realizojmë e bëjmë kot për mos të folur pastaj për buxhetin që është 0 ,buxheti i Këshillit është i pa prekur, është viti i dytë që trashëgohet. Kështu që nëse plani i punës është vetëm mbledhjet e çdo muaji dhe mbledhjet e komisioneve vazhdojmë me rutinën. Pse jemi në

SHQIPËRI
kushte që sot nuk i realizojmë, kur nuk kemi bërë dëgjuesat e buxhetit. Kur nuk kemi bërë një analizë, si do të hartojmë një plan për vitin 2026?

Erjon Sinanaj: Përsa I përket planit të punës së këshillit, unë mendoj që plani duhet hartuar dhe miratuar në bazë të tij ne do të vazhdojmë punën për vitin 2026. Nëse juve si komision nuk jeni dakord hajde ta diskutojmë. Plan i punës së këshillit duhet bërë, nëse nuk doni për shkak të atij buxheti të pa realizuar.

Bujar Mamaj: Po mund të na ndodh prapë e njëjta gjë siç na ndodhi këto 4 muaj pa ardhur asnjë material, pa një plan si do të punojmë ne si këshill pastaj për buxhetin e Këshillit do të vëmë një embargo që këto lekë deri në fund të 4-vjeçarit të mos përdoren nga bashkia ti trashëgoi mandati që do të vij pas nesh.

Taulant Rama: Ideja është kjo nuk e kam patur vetëm te pjesa financiare kur thashë të mos kemi një plan, problemi është se duke qenë në kushtet 0 të bashkëpunimit nga administrata ne jemi dëshmitarë që këtu një drejtues i një drejtorie të caktuar që nuk ka 100% varësi nga bashkia na ka thënë nëpërmjet telefonit i kontaktuar nga nënkryetari i këshillit se nuk jam i lejuar të vi në mbledhje nuk më lë titullari. Pra, unë jam kundër kësaj gjëje dhe po jua them bëfshi planin më të mirë unë do ta votoj kundër dhe unë jam në mënyrë demonstrative siç na sabotojnë neve që nukna sjellin materiale për miratim që shkelin ligjin. Unë jam që vitin pasrendës të shkojmë pa plan. Ndryshe nëse ju e hartoni unë do ta votoj është forma më e keq por më duhet të ruaj dinjitetin dhe autoritetin që po përbuzet dhe po shkelet nga kjo administratë si i do qejfi. Unë bashkë me ju e kemi zhvilluar me buxhetin personal vizitën studimore vitin që shkoi edhe shkoj edhe 100 herë të tjera dhe se kam problem por aman duhet të bëjmë thirrje që administrata me titullarin në krye duhet të jenë më të përgjegjshëm dhe duhet ta shohin këshillin si institucion jo si një rrotë që ju ka zënë atyre bishtin. Kjo është arsyeja që unë e bëj këtë propozim dhe këmbëngul fort që vitin pasrendës të shkojmë pa plan të bëjmë vetëm mbledhjet është e ligjshme që na takon ne për të treguar vërtet nqse dikush mendon se ka vlera. Unë mendoj që ky këshill ka vlera nuk janë ata që prezanton administrata në publik me llafelart e poshtë të shkojmë pa plan vetëm mbledhje, duhet të ruajmë dinjitetin dhe personalitetin tonë që po përbuzet. Ka shkelur ligjin dhe kushtetutën tjetri. Faleminderit!

Xhevit Kacorri: Do të doja që pas këtyre që shprehu Taulanti do të doja që secili nga këshilltarët të shpreh mendimin e tij për atë që ai ka përjetuar sipas komisioneve përkatëse që ka këshilli bashkiak përjetuar për mos ardhjen e raporteve në kohë. Sipas 2025 secili komision të shpreh mendimet e tij për këtë situatë të krijuar nga administrata për këtë situatë që po kalojmë si këshill. Mund të kalojmë në hapa konkrete për 2026.

Esmerald Xhemali: Ne i kemi kërkuar informacion administratës. Administrata nuk përgjigjet.

Asqeri Muçoima: Unë në radhë të parë do të shprehë kënaqësinë time që këshilli në mbledhjen e sotme kthehet në normalitet. Pra dhe ne e ndiejmë tamam detyrën tonë dhe është pozitive që administrata e bashkisë ka sjellë disa projekt vendime këtu. Por do të isha shumë i kënaqur nëse kryetari i bashkisë pas kaq muajsh shpëputjesh, lidhjesh me këshillin e bashkisë të kish ardhur këtu sot dhe të merrte pjesë në këtë mbledhje dhe nuk do të ishte thjesht një ndjesë po do të kishte ngritur vlerat e tij. Kjo mbetet gjithmonë në gjykimin e tij, mua nuk më vjen mirë. Përsa i përket pikës që po diskutojmë unë jam i mendimit që këshilli pa një plan punë nuk mund të shkoj. Ne ta bëjmë atë planin e punës dhe jam dakord dhe me Taulantin e Esmeraldin ne llogari duhet ti kërkojmë administratës. Ne e dimë fort mirë pse nuk kanë ardhur punonjësit e administratës e kemi të qartë. Kanë qenë të ndaluar nga kryetari i bashkisë për të marrë pjesë në mbledhjet e Këshillit, kjo është e qartë po për planin e punës unë kam mendimin tim që duhet ta hartojmë e miratojmë e këtej e tutje, mos të vazhdojmë siç kemi vazhduar por me propozimet e kolegëve jam dakord. Mund të bëjmë

dhe tjetrën të mos kalojmë në një mbledhje pasardhëse nëse administrata me kryetarin e bashkisë nuk sjellin informacionet që kërkon këshilli. Le ta bëjmë dhe publike sepse kemi toleruar jashtëzakonshëm shumë. Por dhe këto bashkitë e forta se ç'rol këshillimor kanë luajtur, sepse nuk u dukën gjëkund u pa rast 4 muaj që nuk pati një ndërhyrje për të zgjidhur problemin sepse njerëzit presin nga ne si këshill. Unë propozoj ta kalojmë si plan dhe për pikat e tjera jam dakord me propozimet e kolegëve. Nëse nuk realizohet fondi i këshillit të mos kalohet asnjë lekë për veprimtaritë e tjera bashkiake dhe në buxhetin e ri të bashkisë ke detyrë kryetar ti kërkoesh llogari çdo zyre deri te zyra e kryetarit të bashkisë. Marr shkas dhe nga ai aktiviteti i zhvilluar në datën 20 nëntor " Dhënie titull "Qytetar nderi " nga Kb. Vendimin e Këshillit e lexon kryetari i këshillit, është ekskluzive i kryetarit të këshillit. Unë dua si anëtarë këshilli që atje në aktivitet të më përfaqësojë kryetari i këshillit, nuk duhet të lexohet nga X punonjës i administratës a qoftë edhe nga kryetari i bashkisë. Jo është me procedurë, është me protokoll le të na thonë dhe këta të bashkive të forta nëse e kam unë gabim këtë gjë . Kryetari i këshillit është i pari që lexon vendimin sipas nr.të vendimit ,datës së vendimit e motivacionit dhe titullin edhe mund t'ia kaloj kryetarit të bashkisë për ta respektuar për t'ia dhënë familjarit apo personit sipas rastit. Të lutem shumë kryetar herë tjetër, sinqerisht e kam me ty direkt mos e tolero këtë situatë.

Erjon Sinanaj: Profesor meqë e përmendët pi ndalem dhe unë tek kjo çështje, është e vërtetë ajo që ju thoni dhe ashtu duhet të ndodhi po tek ceremonia që ne ishim së bashku dhe me këshilltarë të tjerë , këta të bashkisë e morën vetë e dhanë vetë si duket e kishin me shumë qejf këtë pjesë dhe e bënë ashtu si e bënë dhe nuk mund të ngrihesha unë po dale se do vi unë. Për të tjerat bashkërisht ne kemi marrë vendime këtu dhe u kemi dërguar kërkesa , nuk mund të bëhemi polic . Nga ana ime dhe juaj janë dërguar, nuk kam marrë vendime personalisht. Përsa I përket buxhetit kemi dërguar një shkresë ku kërkohet informacion bashkisë dhe jemi në pritje të përgjigjes nga ana e bashkisë. Ka një afat edhe draft buxheti e më pas duhen bërë dëgjuesat që u përmendën nga parafolësit sepse dhe afatet për zhvillimin e mbledhjes së buxhetit janë ndryshe nga mbledhjet e tjera.

Albert Kasi/ koordinatori BtF: Përsa i përket dhënies së titujve të nderit profesori ka të drejtë e ka ligji, ajo nuk ndodh vetëm këtu , ndodh edhe në bashki të tjera, prirja e kryetarëve të bashkisë të dalin vetë të parët e të japin titujt e nderit. Ai është vendim i këshillit bashkiak dhe duhet ta japi kryetari i këshillit. Profesor të falënderojë për pritshmëritë që ke ndaj bashkive të forta po nuk jemi shuars të zjarreve, japim asistencë për hartim planesh, performancë shërbimesh. Kjo asistencë na kërkohet nga bashkitë ne i kemi klient të gjithë megjithatë këtë asistencë e japim kur e kërkonin ju. Megjithatë përpjekje individuale janë bërë por më shumë s'mund të të them. Përsa I përket vendimit për planin e aktiviteteve dhe buxhetit për vitin 2026 duhet ta bëni e kuptoj Taulantin por këshilli bashkiak ka të drejtë e ka dhe pika 5 e kartës evropiane që këshilli bashkiak ka buxhetin e vet dhe e përshkruan qartë. Është detyrim ligjor të njihet buxheti i këshillit duhet kjo të funksionojë.

Flamur Mushamati:Unë mendoj që duhet ta bëjmë planin e aktiviteteve sepse nesër ata që na kanë penguar deri më sot që nuk na kanë sjellë ato që ne kemi kërkuar do thoni ju s'keni një plan pune çfarë kërkonin, pra do ta kenë justifikim mendoj unë. Pra duhetet bërë .

Esmerald Xhemali: Para se të bëjmë këtë planin po s'dëgjova ndonjërin të kërkojë shpjegim për mos realizimin e 2024 e 2025.

Xhevit Kacorri: Fjala ishte këtu që ne të bëjmë një analizë për 2025 sepse këtu u fol nga profesori që ka ndryshuar këtë muja, gjë që nuk e shoh ndonjë ndryshim psh. Këtë muaj duhet të vinte në raport policia bashkiake. A i është kërkuar informacion policisë bashkiake nga sekretarja.

Erjola Allka/ Sekretare këshilli: Po i është dërguar kërkesa për informacion sipas planit të punës.

Xhevit Kacori: Atëherë ku është era e ndryshimit. Kush do referoj sot, përse duhet të bëjmë hipokritin. Të bëjmë një pushim 10 minuta ti japim kohë policisë bashkiake të vij të referojë për rendin në territorin e bashkisë. Pse nuk është në rend dite sot.

Erjon Sinanaj: Të të sqaroj për planin në çdo muaj i dërgohet shkresë administratës nda sekretarja dhe le të ta sqaroj sekretarja. Fjala për sekretaren e Këshillit.

Enjola Alika /Sekretare e Këshillit: E kuptoj shqetësimin tuaj Z. Këshilltarë po pasi është hartuar e miratuar plani i dërgohet administratës. Në vitin pasardhës duke filluar me muajin janar hyn në fuqi dhe fillon puna hap pas hapi për zbatim e planit. Nëse këshilli në një muaj të caktuar ka planifikuar për të marrë në raport X drejtori i dërgohet shkresë në fillim të muajit me tematikën e caktuar. Për çdo muaj duke filluar nga janari deri në nëntor në muajin aktual në të cilin ndodhemi i është dërguar çdo muaj çdo zyre që është planifikuar në planin e aktiviteteve të sjellë informacionin përkatës. Deri në muajin maj me ndonjë vonesë të vogël janë sjellë informacionet përkatëse nga administrata të cilat ju janë përcjellë së bashku me materialet e mbledhjeve përkatëse. Nga muaji korrik e në vazhdim nuk i janë kthyer përgjigje asnjërës nga shkresat të cilat unë e kam pasur detyrim ligjor t'ju dërgoj kërkesë edhe pse bashkia e ka vendimin nr. 1 cili u është dërguar në momentin e miratimit të këtij vendimi. Përsa kohë materiali nuk ishte kryesia nuk e pa të arsyeshme ta përfshinte në rend dite, besoj se isha e qartë. Faleminderit!

Asqeri Muçoima: Përsa i përket fjalës normalitet i referova projekt vendimeve të sjella, shqyr zotit ne sot do të kemi një vendim marrje në dobi të qytetarëve këtë quajta normalitet jo se jam zbutur, ndërsa për informacionin e policisë bashkiake e ka detyrë të raportojë.

Erjon Sinanaj: Përsa i përket diskutimit biem dakord ta lëmë për një mbledhje të veçantë miratimin në një mbledhje jashtë radhe.

Pika 4 e rendit të ditës: " Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi I kushtëzuar 6% I bllok-ndihmës për muajin qershor 2025"

Anest Halili: Do të doja të ishte prezent drejtori i financës për të na dhënë shpjegime për pyetjet që kemi për këtë pikë të rendit të ditës. Disa pyetje nuk mund të na kthejë përgjigje.

Relaton Znj. Laora Hoxha sipas relacionit përkatës.

Asqeri Muçoima: Kemi muajin qershor, pse nuk janë muajt e tjerë?

Laora Hoxha/specialiste e financës: 6% rekomandohen emrat në sistem për ata që nuk dalin fitues, kemi ngelur në muajin qershor sepse po nuk u mbyll me ngarkimin e vendimit të këshillit nuk mund të bëhen rekomandime për muajt pasardhës. Në vazhdim do të jemi me muajin nëntor.

Asqeri Muçoima: Muajt korrik, gusht, shtator, tetor a digjen?

Laora Hoxha: Po, janë djegur.

Taulant Rama: Po qershori pse nuk është djegur.

Laora Hoxha: Nuk është djegur sepse rekomandimet janë bërë në sistem.

Anest Halili: Kush mban përgjegjësi për këto muaj që si kanë marrë përfituesit e kësaj liste këshilli apo bashkia?

Laora Hoxha: Nuk jemi këtu për të gjetur fajtor. Po diskutojmë për të gjetur zgjidhjen më të mirë që njerëzit ti marrin këto lekë ndoshta muajin tjetër pjesën e lekëve që nuk i kanë marrë për këto 4 muaj.

Anest Halili: Janë djegur 4 muaj rresht korrik, gusht, shtator, tetor pse nuk ka ardhur materiali përkatës nga zyra juaj, a mund të më thoni?

Laora Hoxha: Nuk ta jap dot përgjigjen pse nuk ka ardhur.

Edmonda Harizi: Laora me sa dëgjova dhe kuptoj, lejohet 6% i muajit qershor, dakord dhe ne jemi dakord, nuk të pengojmë por këto 4 muaj që njerëzit nuk i kanë marrë. A është ai fond dha a mund të merren 4 muaj së bashku?

Laora Hoxha: Ai fond është po duke qenë se 6% funksionon me sistem ky fond është por nuk mund t'i marrin këta njerëz më këto lekë. Mund të shtojmë familje që ai fond të ezaurohet por në janar do ti heqim prapë këto familje.

Erjon Smanaj: Po ta sqaron specialistja ,administrata nuk i ka sjellë listat përfituese në këshill dhe si rezultat ai fond është djegur. Vetëm qershorin mund të marrin.

Taulant Rama: Ka ndonjë komunikim për mosjelljen e këtyre listave me drejtorin e shërbimit social pavarësisht vendimit të Kryetarit të Bashkisë për mos sjelljen e këtyre listave? Ju keni paraqitur një list në muajin korrik për qershorin , ideja është kjo ne jemi mbledhur muaj për muaj , ju pengonte gjë ju të na sillnit listën. Si e keni marrë urdhërin? Pse nuk i nxorët listat për muajt e tjerë.

Laora Hoxha: Jo nuk mund të dalin përfituesit në sistem pa u mbyllur muaj qershor duke ngarkuar në sistem vendimin përkatës. Për derisa nuk ka pasur një vendim nuk mund ta mbyllim.

Taulant Rama: Ky është buxhet i deleguar, ne i kemi 0 mundësitë që këtë shumë ta përfitojnë familjet në nevojë?

Laora Hoxha: Kjo është situata ne po përpiqemi të gjejmë një zgjidhje.

Taulant Rama: Pse nuk i ka sjellë relacionet zyra juaj për 4 muaj?

Afize Sula: Nuk mund t'i faturohet këshillit bashkiak djegia e këtij fondi ndërkohë keni qenë ju që nuk keni sjellë dokumentacionin përkatës për 4 muaj rresht. Dua një përgjigje të saktë jo kemi një plan.

Laora Hoxha: Ne planin b e kemi pasur për të gjetur një mënyrë për t'u kaluar këto lekë.

Petrit Lumani: A ju ka penguar këshilli bashkiak këto lekë që delegon shteti për familjet në nevojë, pyetja ime është konkrete ,mund të më përgjigjesh?

Laora Hoxha: Jo , nuk kemi pasur pengesa nga Këshilli.

Esmerald Xhemali: Unë disa pyetje ia drejtova dhe në mbledhje të komisionit. Janë 4 muaj që nuk janë paguar dhe pyetja ime konsiston , sa qytetar janë ankuar që nuk i kanë marrë ndihmat për 4 muaj, sepse dua që përgjigjen ta dëgjoni dhe ju.

Laora Hoxha: Atëherë ankesë quajmë kur bëhet në rrugë zyrtare jo me gojë në rrugë apo diku tjetër dhe me protokoll nuk ka asnjë ankesë.

Esmerald Xhemali: Po kur qytetar ankohet tek administratori ose tek specialistët e njësive, ai këtë ankesë që merr nga qytetari i pa informuar ,a kanë bërë ata ankesë për qytetarin, atëherë unë dyshoj se kjo listë është fiktive se nuk qenkan vërtetë në nevojë. Tani mos të ankohet një njeri dhe gjithë kjo administratë mos ta vëri ujin në zjarr , se unë po të isha specialist i administratës nuk i ndihesha titullarit derisa të firmoste jo 4 muaj po 1 ditë po të vonohej se kjo është detyrë funksionale po dhe morale.

Irena Jaupi: Tha që kanë ardhur qytetarët dhe janë sqaruar gojarisht. Çfarë u është thënë qytetarëve nga ana juaj?

Laora Hoxha: U kemi thënë kemi një problem me këshillin dhe po përpiqemi ta zgjidhim.

Afize Sula: Me ç'të drejtë ti e quan problem, ku është problemi këtu?

Petrit Lumani: Më vjen keq po këtu ke gënjyer qytetarin me gjithë respektin që kam për ty personalisht. Flitet për personalitet këtu, na keni futur një pozitë të vështirë me qytetarët.

Afize Sula: Të lozoësh me dinjitetin e këshilltarit nuk është e drejtë e aq më tepër nuk ju takon ju mos merrni përsipër e dashur.

Xhevit Kacorri: Unë jam me të njëjtën linjë me Esmeraldin , nqse këto familje duan një kujdes të veçantë nga bashkia sepse janë vërtet në nevojë, nëse nuk ka reagim atëherë dhe unë mendoj që mund të jenë fiktive. Është bërë listë e re apo ata që kanë qenë në qershor? Unë si këshilltarë nuk mund të marrë përsipër mos zbatim e ligjit nga ana e administratës sepse kam ardhur këtu çdo muaj edhe 2

herë në muaj. Edhe ju personalisht keni shkelur ligjin duke mos bërë detyrën dhe duke gënjyer qytetarët duke u thënë kemi një ngërç.

Anesi Halili: Janë dëgjur 4 muaj, marrim rastin më të keq që nuk kalohen këto lekë dhe digjet fondi. A ndikon kjo në uljen e fondit për vitin e ardhshëm?

Laora Hoxha: Jo nuk ndikon në fondin e vitit të ardhshëm, fondi vjen 6% mbi përfituesit e ndihmës ekonomike të çdo muaji, prandaj vjen dhe çdo muaj.

Hidhet në votim.

Vota Pro 12

Vota Kundër 1

Vota Abstenim 1 Miratohet.

Pika 5 e rendit të ditës. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin korrik-gusht-shtator 2025”.

Esmerald Xhemali: A mund ta thërrasim shefin e financës meqë ka ndikim në buxheti.

Taulant Rama: Administrata nuk e njeh rregulloren e Këshillit Bashkiak po në atë rregullore është një nen që thotë se aktet e sjella nga kryetari i bashkisë duhen mbajtur nga kryetari i bashkisë se nëse nuk është ato nuk miratohen. Se mos nuk na i quajnë se nuk është i pranishëm. Ju kryetar dhe zonja sekretare shikojini njëçik mirë këto procedura.

Erjon Sinanaj: Përsa i përket shkresave ne i kemi dërguar në bashkëpunim me ju nëse nuk je dakord mos e voto.

Erjola Allka/Sekretare këshillit: Në momentin që rendi i ditës miratohet, protokollohet, i dërgohet këshillit, administratës dhe bëhet publik. Në këtë mënyrë veprohet dhe me njoftimin për mbledhjet e komisioneve dhe administrata ka qenë e pranishme në komisionet përkatëse. Përsa i përket pranisë së kryetarit të bashkisë ju qartësoj se sipas ligjit: Kryetari i bashkisë nuk është i detyruar të marrë pjesë në çdo mbledhje të Këshillit Bashkiak, por është i detyruar të marrë pjesë kur kërkohet nga ligji, nga rregullorja e këshillit, ose kur rendi i ditës lidhet drejtpërdrejt me përgjegjësitë e tij ekzekutive. Ligji nuk vendos një detyrim absolut që kryetari të jetë fizikisht në çdo mbledhje por të delegojë dike të përgatisë të gjitha materialet sipas rendit të ditës. Pra, ai ka detyrimin që të sigurojë informacionet, raportimet, projektvendimet dhe llogaridhënien ndaj këshillit. Kur në rend dite janë: Buxheti vjetor, Programi afatmesëm buxhetor, Raporti i performancës së bashkisë, Raportimi mbi gjendjen ekonomike, financiare e sociale të bashkisë. Për këto tema prania e kryetarit është detyrim. Në rastet e tjera delegon dikë.

Taulant Rama: Për mua ky projekt vendim është më i rëndësishëm.

Erjola Allka: Patjetër që të gjitha janë të rëndësishme po përderisa është specialistja për ta mbrojtur nuk është ky rasti për të cilin pyete dhe më sipër.

Anesi Halili: Unë kam të njëjtën kërkesë të jetë drejtori i financës këtu sepse s'mund të vinë 3 muaj bashkë sot kur unë kam qenë në mbledhje në çdo muaj ka pasur edhe nga 2 mbledhje në muaj, në të kundërt unë votoj kundër.

Flamur Mushamati: Këto 3 muaj do të kalojnë së bashku po i katërti pse nuk kalohet?

Laora Hoxha: Për shkak të buxhetit po kalojmë këto 3 muaj këtë herë.

Xhevit Kacorri: A ka shkelje këtu e kam pyetjen për koordinatorin.

Albert Kasi: Unë ju them një gjë u morët me gocën kot se të gjitha projektet aktet po ta vësh re vijnë me firmën e kryetarit të bashkisë. Në momentin që ai nuk i firmos ç'faj ka vajza.

Pyet kryetarin e bashkisë pse zotëri nuk i ke sjellë?

Asqeri Muçoima: Nuk jam dakord fare me koordinatori n e BtF që thotë mos u merrni me specialisten sepse në një mbledhje më herët ju kam pyetur dhe u kam thënë a ka ndonjë ligj për punonjësit dhe më ke thënë po mbajnë përgjegjësi punonjësit në radhë të parë për mosparaqitjen e dokumenteve pastaj kryetari i bashkisë.

Afize Sula: A janë përgatitur nga ana jote projekt vendimet dhe i janë çuar kryetarit dhe nuk janë firmosur?

Laora Hoxha: Po.

Hidhet në votim

Vota pro 9

Vota Kundër 2 A.H, T. R.

Abstenim 3. Miratohet

Pika 6,7,8 propozoj të kalohen në bllok.

Projekt vendim: "Për pranim në shtëpinë e të moshuarve të Z.Dylber Remzi Hasanaj".

Projekt vendim: "Për pranim në shtëpinë e të moshuarve të Znj.Hazbie Feti Xifa".

Projekt vendim: "Për pranim në shtëpinë e të moshuarve të Z.Serjan Hasan Rapaj".

Nuk ka diskutuame. Hidhet në votim.

Vota Pro 13

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 1. Miratohet.

Pika 9 Projekt vendim: "Për emërtim rruge në fshatin Gllavë".

Relaton Ergest Hysesani sipas relacionit bashkangjitur.

Xhevit Kacorri: Kjo rrugë në cilin segment ndodhet?

Ergest Hysesani: Harta është në material, nuk ndodhet në rrugën nacionale po në hyrje të fshatit deri në Qafën e Malasit.

Hidhet në votim

Vota Pro 14

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0. Miratohet.

Pika 10 e rendit të ditës.

Projekt vendim: "Për miratimin e sipërfaqes së pastrimit....

Arsola Muzha: Ne si komision u mbledhëm dhe u sqaruam që vërtet janë vënë emrat e fshatrave po pastrimi u përket hyrjeve të fshatrave që ndodhen përgjatë rrugës nacionale. Këto kosha u shërbejnë më shumë bizneseve që janë përgjatë rrugës. Brenda fshatit na u tha që mbulohet me ndërmarrjen e shërbimit. Ka një shtesë nga vitet e mëparshme sepse janë shtuar disa rrugë nëpërmjet pallateve. Ka një shtesë fondi nga viti i kaluar.

Petrit Lumani: Desha të bëj një korrektim këtu fshati Iliras ka disa kosha në një lagje është 1 kontenier për 60 familje.

Relaton znj. Leonora Mici/Drejtoresh e urbanistikës sipas relacionit bashkangjitur.

Diskutime: Xhevit Kacorri: Meqë është me 2 pjesë shërbimi i pastrimit në komision unë ju kërkova dhe praninë e drejtorit të shërbimeve për informacion më të plotë.

Asqeri Muçoima: Krahasuar me vitin e kaluar, sa është shtuar shuma këtë vit?

Leonora Mici: Afërsisht 10 milionë lekë të vjetra.

Esmerald Xhemali: Ku ndodhet rruga "Medi Kalemi"? Shoh që është 00. A pastrohet kjo rrugë?

Nëse jo. Pse? Grupi i punës ka firmosur. Pse nuk pastrohet kjo rrugë?

Leonora Mici: Të hapim asigun dhe ta shohim ku ndodhet.

Esmerald Xhemali: Po rruga "Sofokli Todhe" ku ndodhet? Kush i pastron këto rrugë?

Leonora Mici: Ato që janë 00 i pastron bashkia sepse kaq është fondi.

Esmerald Xhemali: Në lidhje me projekt vendimin u mbledh komisioni dhe ndër të tjera kërkuam një analizë në lidhje me shërbim që ofrohet përveç operatorit një pjesë të mirë të shërbimit e ofron dhe ndërmarrja e shërbimeve. Ne nuk dimë se sa fshatra, sa kontenier ka drejtoria e shërbimeve sepse duhej të ishte dhe ky informacion për ta plotësuar këtë material. Shoh që ka probleme se meqë është fondi kaq do ta lëmë pa pastruar, fondi mund të shtohet. Fondi kanal se sip. X çmim ka dal kostua s'kemi çfarë të shohim. Duam të dimë çfarë ofron drejtoria e shërbimeve dhe a kryen dot pastrimin se s'mund të lëmë pa pastruar një lagje në Iliras me 60 familje pasi operatori shkon deri atje se po e shtuam dhe këtë lagje nuk ndodh gjë sepse makina e drejtorisë së shërbimeve do të shkoj enkas atje. Unë do propozoja që të shtohen këto lagjet pranë rrugës nacionale që mos të vazhdojnë të ndoten.

Petrit Lumani: Jam shumë dakord me këtë propozim ti shërbehet edhe komunitetit aty.

Afize Sula: Në lidhje me fshatin Lulëzim, lagja e poshtme do të zgjerohet të shtohet një kosh te njësia administrative sepse kanë mbetur moshë të mëdha dhe s'mund ta aksesojnë për shkak të distancës. Po ta shohësh përroin aty është i ndotur sepse në pamundësi për të kaluar rrugën nacionale për shkak të distancës dhe rrezikut janë të detyruar ti hedhin në përrua.

Taulant Rama: Pse vetëm në anë të rrugës nacionale kur fshatrat kanë rrugë dhe mund të futet makina. Nuk është dhe estetike ai segment rruge i mbushur me kosha.

Edmonda Harizi: Dua ta di pastrimi sot vjen për të kaluar a për t'u diskutuar, nëse vjen për të kaluar çfarë diskutojmë?

Leonora Mici : Për të kaluar.

Xhevit Kacorri: Materiali ka ardhur dhe jemi para faktit ta kalojmë ose jo. Duhej të kishin paraprirë grupet e punës. Është domosdoshmëri shtuarja e koshave sepse taksat i paguajnë kanë të drejtë që bashkia t'ia ofroj këtë shërbim. Ju lutem merrni masa për t'i ofruar këtë shërbim njerëzve. Duhet veprime konkrete. Si banor i qytetit shoh nga kalçetua e lartë ska as trotuare, as kazan, kanali është i mbushur plot me mbeturina.

Bujar Mamaj: Jam dakord që lagjet afër rrugës nacionale të shtohen te operatori me të njëjtin fond dhe të hiqen trotuaret se trotuaret bashkia mund t'i fshij me punëtorët e saj.

Petrit Lumani: Dua të di më shumë për studimin sepse shoh që këto që ju keni vendosur jo të gjitha i shërbejnë qytetarit. Mund ta shtrini më gjerë jo vetëm anës rrugës sikur po bëni namin. Janë vendosur 2-3 kosha Qesarat që i shërbejnë vetëm lokalit jo banorëve. Mendoj ta bëni pak më të studiuar për t'i shërbyer komunitetit.

Arsola Muzha: Për ta sqaruar ne kemi pyetur në komision dhe kemi thënë : A pastrohet i gjithë territori?

Kjo sip. tregon vetëm për privatin. Pjesa tjetër pastrohet nga ndërmarrja psh. Shesh Minatori e kam parë që pastrohet nga punonjësit e ndërmarrjes dhe kam pyetur: Pse pastrohet nga ndërmarrja kur këtu i përket privatit?

Leonora më ka thënë kanë bashkëpunuar kur ka qenë shumë pisë për shkak të ndonjë eventit. Kur kemi pyetur pse është bërë kjo lloj ndarje na është thënë se duhet të jenë sa më shumë punonjës në punë.

Leonora Mici: Drejtoria e shërbimeve nuk është vetëm për pastrim, ne bëjmë shumë punë me to.

Taulant Rama: Sa koherent është studimi me atë planin e veprimit që ka drejtoria e shërbimeve, tani ju thatë që mbulohet 100%. Ne kemi vënë re vend grumbullime mbeturinash pra nuk mbulohet 100% ky është fakt. Në Krahës e kini vënë 3 km larg nga fshati koshin. Do bënit mirë të vinit me dy materiale që mbulon firma dhe që ndërmarrja.

Leonora Mici: Nuk kemi ankesa nga qytetarët.

Lauresh Lila: Unë nuk kam asnjë ankesë qyteti është pastruar s'ka rëndësi se firma apo ndërmarrja.

Taulant Rama: Nëse se bën dot le ta bëj të gjithën privati.

Afize Sula: Unë kam komunikuar dhe dua të di a mund t'i riorganizoni këta kontenier për të ofruar një shërbim më të mirë ndaj komitetit. Kam pritur studimin se kam menduar se do të ishte bërë një studim më i mirë.

Edmonda Harizi: Leonora unë të bëra një pyetje në fillim nuk e di se sa më kuptove, të thashë ke ardhur për miratim jo për diskutim, këtu diskutojmë kot se ato gjëra nuk ndryshojnë. Për miratimin e shërbimeve të privatit, këtë më thuaj, këto diskutime thuaj do ti mbaj shënim dhe na jep fjalën që këto shqetësimet tona do ti kaloni te ndërmarrja. Duhej të ishte drejtori këtu. Kush na siguron neve?

Flamur Mushamati: Këtu su fol as për një fshat. Çfarë plani ka për Luftinjen?

Anest Halili: Nuk është dyfish shpenzim të vej dhe privati dhe bashkia për të hequr 2 kosha në Qesarat?

Leonora Mici? Makina nuk vete vetëm për pastrim. Janë të caktuara me ditë se kur do hiqen kazanët.

Largohet nga mbledhja Irena Jaupi.

Esmerald Xhemali: Mos thuaj që ndërmarrja bën shumë gjëra se po të shohësh strukturën i ka të ndara punonjësit e pastrimit, makinën etj. Këtu po flasim për pastrim.

Hidhet në votim: Projekt vendim:

Vota Pro 9

Vota Kundër 4

Vota Abstenim. Miratohet.

Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Këshilltarë pjesëmarrës në mbledhje.

1. Erjon Sinanaj
2. Petrit Lumani
3. Asqeri Muçoima
4. Afize Sula
5. Taulant Rama
6. Irena Jaupi
7. Anest Halili
8. Lauresha Lila
9. Xhevit Kacorri
10. Arsola Muzha
11. Esmerald Xhemali
12. Edmonda Harizi
13. Flamur Mushamati
14. Bujar Mamaj

Sekretari i Këshillit
Erjola Allka



Kryetari i Këshillit
Erjon Sinanaj

